



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-97928, dt: 30 Dhjetor 2024

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Valon (Rexhep) Kaliqani, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 30 Dhjetor 2024, nxjerr këtë:

VENDIM Nr. 71/2024

Mbi Miratimin për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Valon (Rexhep) Kaliqani me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e shtratit të Lumbardhit dhe Hapjen e Shetitores.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e shtratit të Lumbardhit dhe Hapjen e Shetitores.
- II. Parcela kadastrale nr.2214-2 në sipërfaqe prej 152m² ZK Pejë pronë e pronarit Valon (Rexhep) Kaliqani do të merret për nevoja të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e shtratit të Lumbardhit dhe Hapjen e Shetitores, dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelat kadastrale nr.2213-3 në sipërfaqe prej 127m² ZK Pejë dhe nr.3440-20 në sipërfaqe prej 159m² ZK Pejë pronë Komuna Pejë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 06.12.2024.
-Pronat e Komunës, dhe atë ngastrat kadastrale nr.2213-3 në sipërfaqe prej 127m² ZK Pejë është vlerësuar 310.00 €/m² që i bie totali 39,370.00 €, ndërsa ngastrat kadastrale nr.3440-20 në sipërfaqe prej 159m² ZK Pejë është vlerësuar 300.00 €/m² që i bie totali 47,700.00 €. Në total, këto dy prona komunale janë vlerësuar në shumën prej 87,070.00 €.
-Prona private e Valon (Rexhep) Kaliqanit, ngastrat kadastrale nr.2214-2 në sipërfaqe prej 152m² ZK Pejë është vlerësuar 320.00 €/m², që i bie totali 48,640.00 €.
-Ashtu që Valon Kaliqani obligohet Komunës së Pejë t'ia kompenzoj diferencën në shumën prej 38,430.00 €.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësores–Juridike.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në Web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

KRYESUESI I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj

